



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



Nr.02/ 4962/2021

DATA:	13.07.2020
PËR:	KPF dhe Kuvendin Komunal
NGA:	Rufki Suma Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit
LËNDA:	Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm për vitin 2020 (fushëveprimi i auditimit janar-dhjetor 2020 si dhe janar-mars 2021)

I nderuar,

Bazuar në raportin e Auditimit të Brendshëm për komunën e Hanit të Elezit të finalizuar nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, komuna e Hanit të Elezit ka përgatitur Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm për vitin 2020 (fushëveprimi i auditimit janar-dhjetor 2020 si dhe janar-mars 2021).

Po ju dërgojmë:

- **Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm për vitin 2020** (fushëveprimi i auditimit janar-dhjetor 2020 si dhe janar-mars 2021)

Duke marrë në konsideratë Raportin e Auditimit të Brendshëm (MFPT), në pajtim me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit jemi zotuar për adresimin e rekomandimeve të dhëna përmes Planit të Veprimit.

Së bashku me Kryesuesin e Kuvendit të Komunës e kemi harmonizuar agjendën e takimit për shqyrtimin e Raportit të Auditimit dhe Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve në mbledhjen e radhës së Kuvendit (gjatë muajit Korrik 2021).

Po ashtu, në kohë reale do të dorëzojmë Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (30 shtator 2021 dhe 15 mars 2022) sipas kërkesave të daluara nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të muajit tetor 2021 dhe prill 2022, do të diskutojmë në Kuvendin e Komunës për progresin lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për rekomandimet të auditimit të brendshëm.

Me respekt,

Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm për vitin 2020

Nr.	Rekomandimet	Veprimi i menaxhmentit	Data e planifikuar për përfundim	Personi përgjegjës
1	<i>Kryetari i komunës të marrë masa që subvencionet të monitorohen, të kërkohet raporte nga përfituesit, formati i marrëveshjeve të mos përdoret shabllon, por varësisht nga kërkesa e aplikuesit të dihet qartë qëllimi i përfitimit dhe afati kohor i marrëveshjeve.</i>	1. Formimi i komisionit për monitorim të subvencioneve; 2. Thirrja publike për subvencionim duhet plotësisht të përcaktojë qëllimin dhe afatin e shpenzimit për aktivitetet e caktuara; 3. Në marrëveshje të definohet qartë, afati i monitorimit dhe afati i raportimit për subvencionim.	Korrik 2021 Gusht-Tetor 2021	Zyra e kryetarit; Zyra ligjore; Komisioni i monitorimit; Drejtoritë përkatëse.

Data: 13.07.2021

Hani i Elezit